



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen ekstraktet e procesverbaleve dhe transkripteve nga mbledhjet 98, 99 dhe 100 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government


Nr. 02/106
Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë 350.000.00USD (treqindpesëdhjetë mijë dollarë amerikan) për vazhdimin e ndërmarrjes së veprimeve procedurale me karakter urgjent, pranë Qendrës Ndërkombëtare për Zgjidhjen e Kontesteve Investive ICSID (Arbitrazh) në çështjen e ngritur nga kompania "ACT Axos Capital" GMBH për procesin e privatizimit të Postës dhe Telekomit të Kosovës Sh.A.
2. Mjetet financiare nga pika 2. e këtij vendimi ndahen nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 131000, kategoria ekonomike e rezervës dhe transferohen në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, nën programi Departamenti Ligjor me kod 27200 kategoria ekonomike mallra dhe shërbime, për realizimin e pagesës së shërbimit nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e cila do të zhvillojë procedurat.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4 dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Ndahen mjete financiare në vlerë prej 1,093,000 (një milion e nëntëdhjetë e tre mijë) euro, për parandalimin dhe luftimin e sëmundjes gungore të lëkurës së gjedhit, si në vijim:
 - 1.1. 393,000 (treqind e nëntëdhjetë e tre mijë) euro nga Shpenzimet e Paparashikuara, nën programi Shpenzimet e Paparashikuara me kod 13100, kategoria ekonomike e Rezervës.
 - 1.2. 500,000 (pesëqind mijë) euro nga Zyra e Kryeministrit, nën programi Agjensioni Veterinar dhe Ushqimit me kod 40800, rialokohen nga projekti "Kofinancim-faza I- re e projektit për ndërtimin e fabrikës së riciklimit (IPA) me kod 13337.
2. Mjetet financiare nga pika 1.1 dhe 1.2 e këtij vendimi në shumë prej 893,000 (tetëqind e nëntëdhjetë e tre mijë) euro, barten në Zyrën e Kryeministrit, në nën programin Agjensioni Veterinar dhe Ushqimit me kod 40800, në kategorinë ekonomike të shpenzimeve kapitale për projektin " Mbrojtja e shëndetit publik dhe shëndetit të kafshëve me anë të vaksinimeve kundër sëmundjeve infektive të kafshëve " me kod 10014.
3. 200,000 (dyqind mijë) euro sigurohen nga ndarjet buxhetore të Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, nga kategoria ekonomike e subvencioneve dhe transfereve për kompensimin e fermerëve të cilët janë dëmtuar nga sëmundja gungore të lëkurës së gjedhit.
4. Obligohet Zyra e Kryeministrit - Agjensioni Veterinar dhe Ushqimit, Ministria e Financave dhe Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 4 paragrafi 2. të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet në parim Nisma për lidhjen e Marrëveshjes për Bashkëpunim Kulturor ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe shtetit të Japonisë.
2. Përgjatë negociimit të kësaj Marrëveshjeje, obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit të procedoj konform dispozitave të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të Ligjit Nr. 04/L-052 për Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe dispozitave përkatëse në fuqi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për miratimin e vendimit të Komitetit për Partneritet Publiko Privat me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për Projektin e Kompanisë Envidity Energy Kosova LLC, të dorëzuar në Komitetin për Partneritete Publiko Private përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik me anë të shkresës së datës 13.12.2013 me nr. Prot. 2568, duke u mbështetur në nenin 18, paragrafët 3 dhe 7, të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158.
2. Pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të themelohet ekipi për përgatitjen dhe negocimin e marrëveshjes sipas nenit 18, paragrafi 8, të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158.
3. Marrëveshja nga pika 2. e këtij vendimi mund të finalizohet pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Kosovës, me kusht që:
 - 3.1. ajo marrëveshje për investim është në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm;
 - 3.2. marrëveshja për investim i plotëson kushtet e licencimit të përcaktuara me ligj, dhe
 - 3.3. marrëveshja për investim përfshinë përfitime si dhe shpërndarje optimale të rrezikut për Republikën e Kosovës duke tërhequr investime të konsiderueshme direkte apo sigurimin e sigurisë së furnizimit energjetik.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 06/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit Nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet propozimi i Ministrisë së Financave për miratimin e vendimit të Komitetit për Partneritet Publiko Privat me të cilin konstatohet interesi publik nga lëshimi i licencës për projektin e kompanisë SharrCem dhe Titan America të dorëzuar në Komitetin për Partneritete Publiko Private përmes Ministrisë së Financave, me datë 05.08.2013, me nr. prot.1556, duke u mbështetur në nenin 18, paragrafët 3 dhe 7, të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158.
2. Pas aprovimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, do të themelohet ekipi për përgatitjen dhe negocimin e marrëveshjes sipas nenit 18, paragrafi 8, të Ligjit nr. 03/L-163 për Minierat dhe Minerale, të ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-158.
3. Marrëveshja nga pika 2. e këtij vendimi mund të finalizohet pas miratimit të këtij vendimi nga Kuvendi i Kosovës, me kusht që:
 - 3.1. ajo marrëveshje për investim është në përputhshmëri me ligjin e aplikueshëm;
 - 3.2. marrëveshja për investim i plotëson kushtet e licencimit të përcaktuara me ligj, dhe
 - 3.3. marrëveshja për investim përfshinë përfitime si dhe shpërndarje optimale të rrezikut për Republikën e Kosovës duke tërhequr investime të konsiderueshme direkte apo sigurimin e sigurisë së furnizimit energjetik.
4. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia procedoj Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Lista Prioritare e Projekteve Infrastrukturore.
2. Obligohet Këshilli Kombëtar për Investime të bëjë përditësimin sipas nevojës së Listës Prioritare të Projekteve dhe të koordinon procesin e financimit të projekteve që rrjedhin nga Lista Prioritare e Projekteve Infrastrukturore.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/106

Datë: 25.08.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011, dhe të nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 25 gusht 2016, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Botimin e Teksteve dhe Mjeteve Shkollore, Lekturës Shkollore dhe Dokumentacionit Pedagogjik.
2. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Isa MUSTAFA


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë